

Bëjeni zërin tuaj të dëgjohej.

BËNI RADIO!

...dhe Emisione:

Emisioni juaj mund edhe të ridëgjohej

3 TAKOHUNI DHE PLANIFIKONI

së bashku me koordinatorin/en e programit

Paraqisni idenë tuaj të transmetimit në grupin e koordinimit të programit, i cili do të japë komente dhe mbështetje lidhur me çështjet e përmbajtjes, çështjet teknike dhe ato të ligjit mediatik.

Këtu do të njiheni me Radion e Lirë dhe gjithçka që ju nevojitet për transmetimin tuaj të parë. Trajnimi bazë i FREIRAD-it përfshin ligjin për median dhe të drejtat e autorit.

4 MARRËVESHJA E TRANSMETIMIT

S'ka reklamim në transmetim!

Pjesa e shkurtër, por megjithatë e rëndësishme burokratike zhvillohet këtu. Gjeni një kohë të përshtatshme transmetimi dhe nënshkruani marrëveshjen e transmetimit me koordinatorin/en e programit.

5 ANËTAR-SOHU

dhe përfito nga infrastruktura dhe komuniteti FREIRAD

Përpara transmetimit tuaj të parë solo, FREIRAD-i ju mbështet me këshilla teknike në lidhje me studion dhe opsionet e ndryshme të regjistrimit.

Nisni programin tuaj në FREIRAD, drejtpërdrejt ose të regjistruar paraprakisht, në intervalin kohor që dëshironi – një herë në javë, muaj apo një herë në tre muaj.

1 KONTAKTI I PARË

Lexoni këtë fletëpalosje dhe na kontaktoni

Përmirësoni aftësitë tuaja në transmetimin radiofonik me një sërë kursesh dhe seminaresh në fusha të tilla si moderimi i programeve, redaktimi i audiove, shkrimi politik, shkrim-leximi mediatik dhe shumë çështje të tjera.

6 Fillimi i TRANSMETIMIT RADIOFONIK

7 TRANSMETIME TË MËTEJSHME DHE TRAJNIME

në FREIRAD

Akoma je duke dëgjuar, apo ia ke nisur?

FREIRAD-i është një platformë e shoqërisë civile me akses të hapur, që u mundëson të gjithëve të shpërndajnë idetë e tyre në mënyrë që të marrin pjesë aktive në formësimin e një peizazhi mediatik të larmishëm dhe demokratik.

Dëshironi të dëgjoheni? Por nuk dini se ku? Dëshironi ta bëni zërin tuaj të vlefshëm? Por nuk dini se si? Radioja e lirë FREIRAD në Innsbruck është aty për t'ju ndihmuar me këtë. FREIRAD-i ju jep kohë transmetimi në mënyrë që të mund të flisni për atë që është e rëndësishme për ju - qoftë mjedisi, politika, arti, kultura, gratë*, argëtimi, çështjet dhe zhvillimet sociale, teknologjia, brezat, shëndeti dhe shumë më tepër. Bëjeni veten të dëgjuar, pavarësisht se në cilën gjuhë. Eksperimentoni me formate dhe tinguj të ndryshëm ose diskutoni me kolegët tuaj në studio. Nuk keni përvojë? Nuk ka problem! FREIRAD-i ju ofron njohuritë dhe pajisjet e nevojshme, ashtu si edhe trajnim fillestar dhe trajnim të mëtejshëm.

 **freirad**

FREIES RADIO INNSBRUCK

105,9 MHz Zona e Innsbruck-ut
106,2 MHz nga Völs-i deri në Telfs
89,6 MHz nga Hall-i deri në Schwaz

wir@freirad.at | www.freirad.at
Tel. +43(0)512 560291
@freirad_innsbruck
FREIRAD

www.freirad.at

SHPËRNDARJA E FREIRAD-IT

MBI
170

producentë radiofonikë
me ekipin editorial

MBI
400

producentë
radiofonikë në total

24 ORË
365
DITË

kohë transmetimi

MBI
100


seri

MË SHUMË SE
16 gjuhë

Në transmetim
që nga VITI
2002

Frekuencat

UKW 105,9 MHz | 89,6 MHz | 106,2 MHz



FREIRAD-i është një radiostacion i lirë me akses të hapur, një medium për diversitet dhe demokraci. Një radiostacion për të gjithë ata që duan ta bëjnë vetë radio. FREIRAD-i je TI!

Këtu, producentët vullnetarë të radios krijojnë programin. Rreth temave që janë të rëndësishme, në gjuhën që ata zgjedhin. Kritike dhe të hapura. Social-politike dhe të dedikuara. Informative dhe të larmishme. Universale dhe në mbështetje të grupeve të vogla. Lokale dhe ndërkombëtare. Njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe. Radioproducentët ofrojnë shumëllojshmëri mendimesh përmes radios dhe transmetimit tonë në internet, duke e bërë FREIRAD-in në këtë mënyrë, një radio stacion unik në Tirol me diversitetin më të madh të opinioneve dhe gjuhëve.


Dhe e gjitha kjo është jo-fitimprurëse dhe pa reklama, sepse ne themi:

S'KA REKLAMIM NË TRANSMETIM!

Kjo i bën radiostacionet e pavarura shumë të ndryshme nga radiostacionet komerciale publike apo private. Kjo mund të vërehet edhe në program. FREIRAD-i është një radio pa reklama. E pavarur nga interesat e industrisë së reklamave dhe pa presionin monetar.


Ne preferojmë ta rezervojmë këtë hapësirë për njerëzit që duan ta përdorin radion në mënyrë aktive, për t'u përfshirë në diskutime publike dhe për të marrë pjesë në proceset sociale dhe demokratike përmes medias. Prandaj janë veçanërisht të ftuar njerëzit, të cilët vështirë se gjejnë një vend në peizazhin mediatik.

Kjo është detyra më e rëndësishme e FREIRAD-it: t'u japë të gjithëve akses në radio! Nuk kërkohen njohuri paraprake, trajnim gazetaresk apo njohuri të gjuhës gjermane. FREIRAD-i ofron mbështetje, trajnime dhe edukim të mëtejshëm, aftësi mediatike, pajisje dhe infrastrukturë dhe, natyrisht, kohë transmetimi.



DËSHIRONI NJË PËRVOJË UNIKE RADIOFONIKE?

Atëherë prenotoni një hapësirë në dritaren e FREIRAD-it. **Çdo të premte nga ora 19:00 deri në orën 20:00 ka vend për këdo që dëshiron të përçojë çështjet dhe shqetësimet e veta në radio në një program unik. Drejtpërdrejt ose të regjistruar paraprakisht.**



SI U BË FREIRAD-I, FREIRAD?

Skena e radios pirate

FREIRAD-i daton më herët në skenën e radios pirate në Austri në vitet 1980. Në Innsbruck, „Radio Radiator“ transmetohej rregullisht. Megjithatë, pa licencë. Në atë kohë, vetëm ORF-ja lejohej të transmetonte. Nuk kishte asnjë mundësi ligjore për asnjë transmetues tjetër privat.

Piratët e kundërshtuan këtë, bashkuan forcat me aktivistë të tjerë të radios dhe bënë ankesë në Gjykatën Kushtetuese nën emërtimin „Shoqata FREIRAD“. Angazhimi i tyre dha rezultat: Në nëntor të vitit 1993, monopoli shtetëror i transmetimit u rrëzua me një vendim të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.



Shoqata e Radios së Lirë të Innsbruck-ut

Shoqata „Radioja e Lirë FREIRAD Innsbruck“ u themelua në fillim të viteve 1990. Në vitet në vijim, anëtarët iu përkushtuan realizimit të një radiostacioni legal pa pagesë për provincën e Tirolit dhe qytetin e Innsbruck-ut. Kjo përpjekje politike çoi në dhënien e një licence të përkohshme për 14 „ditë radioje“ në vitin 1999. Në nëntor të vitit 2001, u dha një licencë e përhershme radiotransmetimi.

FREIRAD-i nis transmetimin

Më 6 korrik 2002, Radioja e Lirë FREIRAD Innsbruck doli në transmetim dhe që atëherë ka transmetuar një program 24-orësh jo komercial dhe pa reklama. Që atëherë, ajo ka qenë një antitezë e rëndësishme dhe një shtesë e domosdoshme për mediat komerciale publike dhe private, dhe me të drejtë e përshkruan veten si stacioni radiofonik me diversitetin më të madh të opinioneve në Tirol.



Nuk dëshironi të merreni me radio, por prapëseprapë dëshironi të mbështesni diversitetin e opinioneve?

Bëhuni anëtar ose mbështesni punën tonë me një donacion.

IBAN AT81 1400 0668 1098 6981 | BIC BAWAATWW
Referenca e pagesës: Tarifa e anëtarësimit ose dhurimi, Viti, Emri

Impressum

Shoqata Radioja e Lirë Innsbruck - FREIRAD
Egger-Lienz-Straße 20 / Stöckel Building, 6020 Innsbruck

Danke an



INNS' BRUCK

